

LIGJ
Nr.9766, datë 9.7.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Tabela nr.1 “Tabela për tatimin mbi të ardhurat”, referuar në nenin 9 e që i bashkëlidhet ligjit, zëvendësohet me pasqyrën nr.1, me të njëjtin titull, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Në nenin 21 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 1 shkronjat “h” e “j” ndryshohen si më poshtë:

“h) shpenzimet për përfaqësim dhe shpenzimet për pritje-përcjellje, të cilat tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;”

“j) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte të tjera nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar në ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, për qëllime tatimore, nuk njihen si shpenzime të zbritshme shumat e sponsorizuara, që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shumat e sponsorizuara për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit”.

2. Pas shkronjës “m” shtohen shkronjat “n”, “nj” e “o” me këtë përmbajtje:

“n) shpenzimet për paga, shpërblime dhe çdo formë tjetër e të ardhurave personale, të cilat lidhen me marrëdhëniet e punësimit, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë edhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar.

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rastet e përjashtimit nga ky rregull;

nj) shumat e paguara në cash, mbi kufijtë e përcaktuar në nenin 36/1 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

o) shpenzimet për shërbime të ndërtimit, montimit dhe punime të tjera të faturuara shoqërive të ndërtimit, nga tatimpagues të biznesit të vogël.”.

3. Në pikën 2 fjalja e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Ky kufizim nuk zbatohet për bankat, shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e leasing-ut.”.

Neni 3

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28
Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin deri më 31 dhjetor 2007 është 20 për qind, ndërsa nga data 1 janar 2008 do të jetë 10 për qind.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5395, datë 16.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

PASQYRA NR.1
TABELA PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

E ardhura e tatueshme (në muaj)	Përqindje	
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	
0	10 000	0 për qind
10 001 +	30 000	+ 10 për qind të shumës mbi 10 000 lekë
30 001 +	Më tepër	10 për qind të shumës mbi 0 lekë